



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 25, Datë 14.02.2022

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “HEC TERFOJA”
SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “d”, të ligjit nr. 43/2015, *Për sektorin e energjisë elektrike*; i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “e”, nenit 5, pika 1, gërma “e”, nenit 10, pika 3, të *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.06.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 19, pika 1, gërma “a”, të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.02.2022, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 204/3 prot., datë 02.02.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, “*Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “HEC TERFOJA” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike*”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “HEC TERFOJA” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 175 prot., datë 24.01.2022 ka paraqitur aplikimin për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Shoqëria “HEC TERFOJA” sh.p.k., ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të Aneksit A, të “*Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*”, të ndryshuar..
- Nga shqyrtimi i dokumentacionit në fazën e fillimit të procedurave të licencimit në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për shoqërinë “HEC TERFOJA” sh.p.k., rezulton se subjekti plotëson kryesisht kërkesat e “*Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*”, të ndryshuar, si më poshtë:
 - Formati dhe dokumentacioni për aplikim. Neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b” dhe “c”.

Plotësuar.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor. Neni 9, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c”. **Plotësuar;**
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal. Neni 9, pika 3, gërmat “a”, “b”, “d”. **Plotësuar.**
- Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:
Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor. Neni 9, pika 2:
 - **gërma “d”** (vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë). **Plotësuar pjesërisht.** Shoqëria duhet të depozitojë në ERE vërtetimet e gjykatës dhe të prokurorisë me data të përditësuara.
 - **gërma “e”** (Struktura e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të shoqërisë, sipas pozicioneve dhe profileve përkatëse. **Plotësuar pjesërisht.** Shoqëria duhet të përcjellë në ERE strukturën e organizmit të saj ku të përfshihet edhe stafi përkatës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë.

Dokumentacioni financiar dhe fiskal. Neni 9, pika 3:

- **gërma “c”** (dokumenta që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera), **Pa plotësuar.** Shoqëria duhet të depozitojë në ERE sa kërkon kjo pikë e rregullores.

Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike. Neni 9, pika 4.8:

- **gërma “a”** (sasia e energjisë elektrike e parashikuar për t’u tregtuar në GWh / sipas viteve); **Pa plotësuar.** Shoqëria duhet të paraqesë sasi të energjisë të parashikuara për t’u tregtuar në GWh për pesë vitet e licencës.
- **gërma “b”** (kapitali financiar i parashikuar për ushtrimin e këtij aktiviteti); **Pa plotësuar.** Shoqëria duhet të paraqesë në ERE dokumentacionin përkatës, do të njoftohet subjekti që në bazë të neneve 10, pika 10 dhe 11, të *“Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”*, të ndryshuar, t’i paraqesë ato brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “HEC TERFOJA” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5- vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI